



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.567/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS –Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Banka për Biznes (BPB) SHA me nrb.70062470 me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallë së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.285/22 të datës 30.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit Banka për Biznes (BPB) SHA me nrb.70062470 me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallë së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.285/22 i datës 30.11.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallë së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.285/22 i datës 30.11.2023, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit Banka për Biznes (BPB) SHA me nrb.70062470 me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit 01nr.315/2019 i datës 10.06.2019 dhe vendimi 01.nr.33-26/2019 i datës 21.02.2019, i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, në Prishtinë,

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që Dhomat e shkallës së dytë, ta aprovoj në tërsi ankesën e paditësit, të anuloj në tërsi aktgjykimin e Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallë së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.285/22 i datës 30.11.2023 dhe kjo çështje të kthehet në rishqyrtim dhe

rivendosje, apo të Ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që të Aprovohet si e themelt padia e paditësit, të Anulohet vendimi 01nr.315/2019 i datës 10.06.2019 dhe vendimi 01.nr.33-26/2019 i datës 21.02.2019, i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, në Prishtinë,

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, në Prishtinë, me vendimin përfundimtar 01nr.315/2019 i dates 10.06.2019, në procedurën administrative të ankesave, ka refuzuar ankesën e paditësit Banka për Biznes nga Prishtina, dhe ka vërtetuar vendimin 01nr.33-26/2019 date 21.02.2019 i nxjerr nga inspektorati i punës.

Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë duke inicuar konflikt administrativ kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, në Prishtinë, respektivisht ka kundërshtuar vendimin 01nr.315/2019 i datës 10.06.2019 dhe vendimin 01.nr.33-26/2019 i datës 21.02.2019, i të paditurës, me arsyetimin se vendimet janë të pa drejta dhe të kundërligjshme.

Dhoma e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 13.11.2023, në praninë e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të përfaqësueses së palës së paditur, (neni 41 i LKA-së), pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, vendosi që ta refuzoj padinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë referohet në nenin 94 të Ligjit të Punës dhe Ligjit 2002/9 për Inspektoratin e Punës, nenin 4 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke dhënë konstatimin se vendimet e kundërshtuara janë në pajtim me ligjin dhe në përputhje me autoritetin për shqiptimin e masave ndëshkuese. Gjykata nuk vërtetoi pretendimet e paditësit për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të dispozitave materiale. Inspektorati ka vepruar brenda kufijve të kompetencës për shqiptimin e gjobës me nxjerrjen e vendimit të kontestuar në përputhje me nenin 5 par.5 të Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të dhomës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës

së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK).

Kolegji vlerësoi se e paditura me rastin e vendimmarrjes si organ i shkallës së parë dhe të dytë, në procedurën administrative, ka zbatuar drejt dispozitat nga Ligji 03/L-212 i Punës në Kosovë, kur në bazë të gjeturave nga raporti zyrtar i inspektoratit të punës dt.26.10.2018 dhe 12.11.2018, ka ndëshkuar paditësin me gjobën totale administrative prej 4,000.00€, dhe ka vërtetuar këtë gjobë me vendimin përfundimtar, për shkak se i njëjti ka rënë ndesh me dispozitat e nenit 92 të Ligjit 03/L-212 të Punës. Shkeljet e dispozitave ligjore të konstatuara nga inspektimi, rezultojnë për shkak se paditësi i ka ndërprerë pushimin e lehonisë punëtorese Jehona Gashi ne kundërshtim me nenin 49 par. 4 dhe 5 të Ligjit të Punës , vlerësimi i performancës për punëtoren është bërë për vitin 2017 ndërsa punëtorja në pjesën e parë të këtij viti ka qenë në shfrytëzimin e pushimit të lehonisë, vlerësimi i performancës është bërë gabimisht për pozitën e zyrtare ne thesar kurse në kontratën e punës figuron pozita zyrtare trezor, janë kontradiktore vendimi për ndërprerjen e kontratës së punës me vërejtjen e shqiptuar.

Gjithashtu Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vlerësoi se gjatë konfliktit administrativ, dhoma e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar të paditurës, në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejt ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit Banka për Biznes (BPB) SHA me nrb.70062470 me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit 01nr.315/2019 i datës 10.06.2019 dhe vendimit 01.nr.33-26/2019 i datës 21.02.2019, i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, në Prishtinë, Kolegji vlerësoi se në arsyetim të aktgjykimit ankimor, janë dhënë konstatimet faktike dhe ligjore sa i përket shkeljeve ligjore të paditësit me rastin e paraqitjes së ankesës së punëtorese nga marrëdhënia e punës, dhe në këtë rast dhoma e shkallës së parë me të drejt ka dhënë konstatimin se shqiptimi i gjobës për shkelje të dispozitave të ligjit të punës është kompetencë ekskluzive e inspektoratit, në përputhje me nenin 5 pika 5.5 të Ligjit të Inspektoratit të Punës.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit, se janë bërë shkelje të dispozitave të nenit 183 të LPK-së, se Dhoma e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike në raport me pozitën e punës së ish punëtorese, se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje esenciale të nenit 182 par.1 të LPK-së, nenit 160 paragrafi 4 i LPK-së, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara në ligj dhe të argumentuara në provat e lëndës, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet

vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga dhoma e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjithashtu Kolegji, vlerësoi se dhoma e shkallës së parë, nga provat që i ka administruar, me të drejt ka vërtetuar shkeljet ligjore në këtë rast nga paditësi në cilësinë e punëdhënësit, në raport me ish punëtoren J.G.B., duke nxjerr konstatimin se gjoba administrative e shqiptuar nga inspektorati i punës ndaj paditësit, e sanksionuar me dispozitën e nenit 7 të udhëzimit Administrativ nr.07/2022, është në pajtim me nenin 94 të Ligjit të Punës. Kolegji duke vlerësuar provat e administruara nga dhoma e shkallës së parë gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje të nenit 182 par.1 dhe 160 par.4 të LPK-së, sepse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, janë dhënë shpjegimet faktike vendimtare që rezultojnë nga raporti zyrtar i inspektimit të paditurës. Paditësi para gjykatës së shkallës së parë, me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e tij që gjejnë mbështetje faktike apo ligjore, prandaj pretendimet ankimore nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar, Kolegji, konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësorë të dispozitave ligjore, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.567/24 datë 18.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha